

Prof. Dr. Aurela Anastasi

Enkelejda Olldashi (master)

**SISTEMET E KUOTAVE ZGJEDHORE DHE RËNDËSIA E TYRE PËR
ARRITJEN E BARAZISË GJINORE NË JETËN PUBLIKE**

*“Pikërisht, meqë forcat e rrethanave kanë përherë si prirje të shkatërrojnë barazinë,
duhet gjithmonë që forcat e legjislacionit ta ruajnë atë”*

Ruso

1. Vështrim historik dhe i krahasuar mbi përpjekjet për ndalimin e diskriminimit gjinor në sistemet zgjedhore.

Diskriminimet e bazuara mbi përkatësinë gjinore, kanë qenë të vështira për t'u eliminuar veçanërisht në jetën publike. Në të gjitha shoqëritë, evolucioni drejt barazisë midis burrit dhe gruas ka qenë mjaft i ngadalshëm. Për një kohë të gjatë, kjo gjë u stimulua edhe nga e drejta zakonore e vendeve, si dhe nga ajo kishtarë. Kështu, shpjegohet fakti që deri pas Luftës I Botërore, zotëroi votimi i përgjithshëm mashkullor duke u vendosur kufizime të mëdha për pjesëmarrjen aktive e pasive të qytetarëve në zgjedhje. Gjithashtu, universitetet dhe detyrat qeveritare zyrtare, iu rezervuan burrave. Presioni social ishte kaq i fortë, saqë praktikisht, ishte e pamundur që një grua të ngrihej nga pikëpamja sociale për shkak të cilësive morale dhe intelektuale që gëzonte.

Revolucionet borgjeze shtruan seriozisht çështjen e respektimit të të drejtave të grave në fushën juridike. Gratë peticionare levelere në Revolucionin anglez, gratë franceze gjatë Revolucionit francez etj., janë pionieret e luftës për të drejtat e grave. Në vitin 1791, e frymëzuar nga Deklarata e të Drejtave të Njeriut dhe të Qytetarit (1789), në Francë u publikua “Deklarata e të Drejtave të Gruas” nga *Olympe De Gouges*, e cila nuk pati suksesin e dëshiruar. Më tej, ishte një tjetër grua, mësuesja angleze *Mary Wollstonecraft* (1759-1797), që rreth një vit më vonë, më 1792, publikoi manifestin e saj feminist *Vindication of the rights of women*. Ky manifest, afirmonte të drejtën për arsimimin e gruas dhe njohjen e të drejtave të saj civile e politike. Në këto akte vihej në dukje se, situata anakronike e gruas ishte rezultat i injorancës në të cilën ajo ishte mbajtur deri tani.

Historikisht, Kuvendi i parë e të Drejtave të Gruas u organizua në *Seneca Falls* në shtetin e Nju Jorkut. Në këtë Kuvend asistuan 260 gra dhe 40 burra. Deklarata e *Seneca Falls* shprehej për barazinë e të drejtave të grave dhe për pjesëmarrjen e gruas në procesin e votimit: “burri nuk mund të drejtojë i vetëm racën njerëzore, pa ndihmën dhe pa

pjesëmarrjen e gruas”. Kështu, e gjithë gjysma e dytë e shek.IX u karakterizua nga lëvizjet e njohura feministe që kërkonin kryesisht të drejtën e votës, të drejtën për punë, dhe të drejtën e tyre për arsim. Në Britaninë e madhe, përpara adoptimit të reformave ligjore të nevojshme, u shtrua nevoja për ndryshime në të drejtat e grave. Për këtë, dhanë një ndihmesë të rëndësishme gratë e mirënjohura shkrintare, poete etj. Në vitin 1897, *Millicent Fawcett* krijoi Bashkimin kombëtar për votimin e grave (*National Union for Women Suffrage*). Ky Bashkim do të përdorte për arritjen e synimeve të tij, metoda ligjore dhe jo të dhunshme. Megjithatë, në ndonjë rast, anëtarët e Bashkimit kërkuan të drejtën e votës duke kaluar edhe në veprime brutale, vendosnin bomba, shkatërronin vitrinat, kryenin greva urie, iu vinin zjarrin ndërtesave publike. Historia e njeh tashmë këtë Bashkim dhe lëvizjet e tij, me emrin që iu dha atyre një gazetë angleze: *sufrazhetet*.

Në vitin 1913, Dhoma e Komuneve në Angli e hodhi poshtë votën për gratë. Por, përpara përfundimit të Luftës I Botërore, më 6 shkurt 1918, një ligj i akordoi grave të drejtën e votës, duke filluar nga mosha 30 vjeç. Dhjetë vjet më vonë, barazia në të drejtat civile midis burrave dhe grave, u miratua nga Dhoma e Komuneve. Por, cenzet e ruajtura ishin kaq të mëdha, saqë praktikisht e bënë të pamundur këtë barazi. Deri pas Luftës së II Botërore numri i grave që mund të votonin në Angli ishte kaq I vogël, saqë ato numëroheshin me gishta¹.

Në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, lëvizjet feministë ishin më rezultative se sa ato që u zhvilluan në Evropë. Këto lëvizje filluan aty nga shek.XIX dhe morën formën e *Women's Clubs*². Këto shoqëri grash u bënë shumë të fuqishme. Në vitin 1890, “*National American Women Suffrage Association*”, gruponte në vetvete edhe shoqata të tjera, si shoqata lokale, ashtu edhe shoqata me shtrirje kombëtare. Ajo mblodhi të gjitha forcat për të adoptuar të drejtën e votës për gratë në disa shtete dhe pastaj në të gjithë vendin. Në vitin 1889 u krijua Këshilli Ndërkombëtar i Grave dhe, në vitin 1903 u krijua Aleanca e Grave për votimet. *Emma Goldman* në librin e saj “*Living my life*” paraqet përpjekjet e bëra nga gratë anëtare të kësaj lëvizjeje, për miratimin e kërkesave të tyre. Rezultati erdhi në vitin 1920, kur me amendamentin kushtetues nr.XIX, shpallej se, e drejta e votës ishte e përgjithshme dhe e barabartë, pavarësisht nga seksi. Kështu, u kurorëzuan me sukses një varg lëvizjesh feministe. Megjithatë kjo shënonte vetëm një nga objektivat e kësaj lëvizjeje.

Në Angli, në vitin 1918, qeveria e liberalit Lloid Xhorxh, propozoi një ligj të ri elektorat: “*Representation of the people act*”, i cili u miratua nga Parlamenti dhe u shpall po atë vit. Në fakt, ky ligj sanksionoi parimin e përgjithshëm mashkullor të votimit. Në bazë të tij kishin të drejtë të votonin të gjithë personat meshkuj që kishin mbushur moshën 21 vjeç, të cilët plotësonin kërkesat e cenzit të banimit ose zotëronin lokale për ushtrimin e një profesioni. Megjithatë, krahas këtij parimi, për herë të parë u jepej e drejta politike grave, por kjo varej nga arritja e moshës 30 vjeç si dhe nga disa kërkesa të tjera: ajo duhet të ishte e martuar, të kishte titull universitar dhe të kishte një pronësi të caktuar. Ligji nuk i përmbahej parimit të barazisë së votimit sipas të cilit një njeri duhet të kishte një votë.

¹ Për më gjerë, shih: Kristo Floqi, *E drejta Themelore*, Shkodër 1920

² Rreth femërore ku gratë mblidheshin për të diskutuar problemet e tyre politike dhe ekonomike të momentit

Me ligjin e propozuar nga qeveria konservatore e Balduin, “*Equal franchise act*”, i cili u shpall në vitin 1928, e drejta për të votuar iu dha edhe grave në kushte të barabarta me burrat.

Në Francë, ishte kushtetuta e Republikës IV franceze, pra ajo e vitit 1946, e para që parashikoi se, “ligji i garanton gruas, në të gjitha fushat, të drejta të barabarta me ato të burrit”. Qysh në vitin 1944, *ordinanca* e Qeverisë së Përkohshme të gjeneralit De Gol, iu kishte dhënë të drejtën e votës edhe grave. Gratë franceze morën pjesë në votimet për zgjedhjet e organeve lokale të prillit 1945. Tridhjetë e tre gra u zgjedhën në Asamblenë Kushtetuese të 21 tetorit 1945. Kështu, qysh pas Luftës II Botërore në Francë, pozita juridike e grave do të evoluonte drejt zhvillimit dhe mbrojtjes së personalitetit të saj. Kjo mund të thuhet si në sferën publike, ashtu edhe në sferën private dhe ekonomike.

Në Shqipëri, pesha e rëndë e traditës dhe e të drejtës zakonore shqiptare, si dhe ndikimi i pushtimit të Perandorisë otomane për më tepër se pesë shekuj, e kishte mënjanuar krejt gruan nga jeta social-politike. Deri në Luftën II Botërore nuk bëhej fjalë për pjesëmarrjen e grave në votime dhe në jetën politike të vendit. Me ardhjen në pushtet të Ahmet Zogut, më dhjetor të vitit 1924, burimi kryesor i të drejtës së zgjedhjeve u bë ligji "Për zgjedhjen e Dhomës së Deputetëve" i miratuar nga Kuvendi Kushtetues më 23 shkurt 1925. Ligji u mbështet plotësisht në atë paraardhës të vitit 1923, duke sanksionuar të njëjtat parime e procedurë zgjedhjesh. Ligji i zgjedhjeve sanksiononte parimin e përgjithshëm të votimit, por parimin e përgjithshëm mashkullor, pra nuk u siguronte të drejtën e votës grave. Në botën demokratike të kohës, vendosja e parimit të përgjithshëm edhe femëror, si shprehje më demokratike e zgjedhjeve, u bë relativisht vonë e me përpjekje të mëdha të lëvizjeve feministe. Por, ngadalësia në Botë nuk ishte shkak i vetëm për të mos e pretenduar këtë gjë nga ligji ynë i atëhershëm elektorale. Për shoqërinë shqiptare, për shkak të pozitës shoqërore të gruas, ishte ende vështirë të hidhej hapi që në mjaft demokraci të konsoliduara u hodh vetëm më periudhën e dy luftërave botërore. Ndërkohë, u ndërmor edhe ndonjë reformë për emancipimin e gruas. Kështu, jehonë të veçantë shkaktoi miratimi nga Parlamenti në vitin 1937, i ligjit për ndalimin e perçes tek gratë myslimane. Menjëherë, qeveria mori masa për zbatimin e tij sa më parë. Ajo theksoi se, në rast nevojë, çarçafi do të ndalohej edhe me forcë, pasi ai ishte antiligjor dhe antishoqëror, ndihmonte në lidhjen e martesave pa njohjen dhe pëlqimin e palëve, dëshmonte për skllavërimin e gruas etj. Ky ligj, në të njëjtën kohë, shkaktoi një varg përgëzimesh ndaj qeverisë, por edhe një varg peticionesh kundër saj. Madje, në këto të fundit shpreheshin edhe kërcënime, duke rrezikuar për mbylljen e grave në shtëpi etj. Reaksioni u ndie më tepër në qytetin e Shkodrës. Madje, në këtë qytet, për një propagandim konkret të ligjit, Mbreti Ahmet Zogu i I-rë, dërgoi tri motrat e tij, të cilat shëtitën të veshura me veshje prerëndimore nëpër rrugë³.

Edhe në shume vende të Evropës duhet të pritej shekulli XX, që gratë të arrinin gëzimin e të drejtave politiko-juridike. Pas Luftës II Botërore ato arritën të fitonin qytetarinë e plotë politike. Kjo arritje ishte një shpërblim që iu dha grave për taksën e paguar në luftën dhe në rezistencën kundër fashizmit. Ideja për sanksionimin e barazisë së burrit me gruan më në fund kishte triumfuar. P.sh., gratë shqiptare patën mundësi të votonin për herë të parë

³ Shih: Aurela Anastasi, Institucionet politike dhe e drejta Kushtetuese në Shqipëri (1912-1939), Shtëpia Botuese “Luarasi”, Tiranë, 1998, fq. 261

pas Luftës II Botërore, pasi deri në atë kohë të gjitha ligjet kushtetuese shqiptare kishin njohur vetëm parimin e përgjithshëm mashkullor të votimit. Ato morën pjesë në zgjedhjet për Asamblenë Kushtetuese që u zhvilluan në dhjetor të vitit 1945. Më tej për herë të parë në historinë kushtetuese shqiptare u afirmua barazia e të drejtave midis burrave dhe grave, me Kushtetutën e Republikës Popullore të Shqipërisë të vitit 1946. Fitorja e një vargu të drejtash pas luftës lidhet me pjesëmarrjen aktive të grave në rezistencën kundër fashizmit, por edhe me klimën e përgjithshme të favorshme që u krijua pas Luftës II Botërore, si rezultat i fitores së forcave demokratike mbi totalitarizmin. Sidoqoftë barazia juridike e të drejtave nuk ishte e thjeshtë për t'u zbatuar. Rruga për ta arritur atë realisht ishte e gjatë.

Mohimi i të drejtës elektorale për gratë ka qenë cenzi më i madh që i jepte karakter antidemokratik të drejtës së zgjedhjeve. Pjesa më e madhe e popullsisë në të gjitha vendet, nuk merrte pjesë në votime për shkak të këtij cenzi. Gratë e fituan të drejtën e zgjedhjes (aktive e pasive) vetëm në saje të lëvizjeve të vazhdueshme dhe këmbënguljes së organizatave të tyre në të gjitha vendet.

2. Sanksionimi i barazisë gjinore në aktet kryesore të të drejtës së brendshme dhe asaj ndërkombëtare.

Shumë vende të Evropës Perëndimore, në kushtetutat e pas Luftës II Botërore (Francë 1946, Itali 1947, RFGJ 1949) e sanksionojnë në mënyrë të shkruar këtë barazi. Kështu, afirmohet barazia midis sekseve në të gjitha fushat ligjore. Ky fakt, përbën një kurorëzim të suksesshëm të mjaft lëvizjeve feministe në Evropë dhe në SHBA. Kjo është bërë përgjithësisht në disa nga kushtetutat e vendeve evropiane, të cilat e sanksionojnë nenin klasik të barazisë P.sh., si të tillë mund të përmendim nenin 3 të Kushtetutës gjermane: *“Të gjithë njerëzit janë të barabartë përpara ligjit. Burrat dhe gratë kanë të njëjtat të drejta....”*. Të bën përshtypje fakti se legjislatori gjerman ka këmbëngulur për evidentimin e barazisë midis burrit dhe gruas. Kjo gjë mbizotëron mbi listën tjetër të burimeve të pabarazisë që ai ka renditur.

Në Britaninë e Madhe, karakteristikë e të cilës është mungesa e një kushtetute në kuptimin formal të kësaj fjale, janë miratuar disa akte që i sigurojnë gruas gëzimin e një barazie të plotë formalo-juridike me burrin. P.sh., një *bill* që ndalon diskriminimin për shkak të seksit, (*“Sex Discrimination Bill”*) është miratuar nga Dhoma e Komuneve më 26 mars 1975. Ai e deklaron të paligjshëm diskriminimin e grave si nga pikëpamja e financimit të saj ashtu edhe nga pikëpamja e shërbimit. Kurse, *“Equal Pay Act”*, i shpallur në vitin 1970, ndalon diskriminimin e grave për marrjen në punë ose diferencimet midis pagave të punonjësve ekzistues. Megjithatë disa përjashtime të kufizuara parashikohen nga vetë ligji.

Gjithashtu, Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut (1948), nuk harron të shpallë barazinë midis sekseve, sikurse barazinë midis bashkëshortëve. Në mënyrë të veçantë, eliminimi i diskriminimit mbi bazën e përkatësisë gjinore dhe pjesëmarrja e grave në

jetën politike është sanksionuar në Konventën e Kombeve të Bashkuara “Për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj Gruas” (CEDAW)⁴.

Këto aspekte u pasqyruan edhe në aktet kruesore kushtetuese në Shqipëri me pas ndryshimeve që ndodhën në fillim të viteve '90. Midis tyre ka rëndësi të veçantë: Ligji Nr. 7692, date 31.02.1993 “Per një shtojcë në ligjin nr. 7491, datë 29.04.1991 “Për Dispozitat Kryesore Kushtetuese”, “Mbi te drejtat dhe liritë themelore të njeriut”. Në këtë ligj, barazia e qytetarëve shprehet qartë në nenin 25 (“Barazia përpara ligjit”). Në bazë të këtij neni, të gjithë qytetarët janë të barabartë në ligj dhe përpara ligjit duke gëzuar një trajtim dhe një mbrojtje ligjore të njëjtë pavarësisht nga seksi.

Edhe pse legjislacioni i ri kushtetues ofroi një sërë kushtesh e garancish formale për zgjerimin e pjesëmarrjes së gruas në jetën politike të vendit, përfaqësimi i gruas në jetën publike ra ndieshëm. Të dhënat statistikore tregojnë se kjo gjendje nuk u përmirësua edhe pas miratimit të Kushtetutës së vitit 1998, e cila u përpoq të sillte risi në nenin klasik të barazisë⁵. Një gjendje e varfër paraqitet edhe nga tabloja e parlamentit aktual, i cili e

- ⁴ Neni 7 i KONventës së CEDAW_t: “Shtetet palë marrin të gjitha masat e duhura për të eliminuar diskriminimin e gruas në jetën politike dhe publike te vendit. Në mënyrë të veçantë i siguron, në kushtet e barazisë me burrat, të drejtën që ajo:
 - A. Të votojë në të gjitha zgjedhjet dhe në të gjitha referendumet publike, si dhe të zgjidhet në të gjitha organizmat publikisht të zgjedhur....
 - B. Të marrë pjesë në përpunimin e politikës qeveritare dhe në përpunimin e saj; të punojë në postet publike dhe të kryejë funksionet publike në të gjitha hallkat e qeverisjes.
 - C. Të marrë pjesë në organizatat dhe shoqatat joqeveritare që merren me jetën publike dhe politike të vendit.

⁵Shih statistikat që vijojnë: *

VITET	LEGJISLATURAT	DEPUTETË	GRA	%
8 Janar 1920				0
21 prill 1921				0
1 Qershor 1925				0
1928-1939				0
1945-1950	Legjislatura e I	82	6	7.4
1950-1954	Legjislatura e II	121	17	14
1954-1958	Legjislatura e III	134	16	11.9
1958-1962	Legjislatura e IV	186	17	9
1962-1966	Legjislatura e V	214	25	11.6
1966-1970	Legjislatura e VI	240	39	16.25
1970-1974	Legjislatura e VII	264	71	26.8
1974-1978	Legjislatura e VIII	250	88	33.6
1978-1982	Legjislatura e IX	250	81	32.4
1982-1986	Legjislatura e X	250	78	31.2
1986-1991	Legjislatura e XI	250	75	30

shpie pjesëmarrjen e grave në 7,1%, e cila përbën padyshim, përqindjen më të ulët të përfaqësimit në të gjitha parlamentet evropiane.

Historia dhe përvoja e deritanishme u ka dhënë disa mësim të rëndësishme grave shqiptare në përpjekjet e tyre për pjesëmarrjen aktive në pushtetin politik. Ato janë bërë të ndërgjegjshme tashmë se, në saje të aktivitetit të tyre u arrit barazia me burrat në ligj. Kjo do të thotë se formalisht, ligjet shqiptare nuk sanksionojnë kurrfarë diferencimi e diskriminimi ndaj grave, porse në praktikë, mund të ndeshen edhe raste të diskriminimit, të mënjanimit nga aktiviteti politik, nga puna e shoqëria, të keqtrajtimit e të barrës së madhe të punëve familjare për 'to. Në këto kushte, shoqëria ka ende për të bërë që, barazia e mundësive të shndërrohet në rezultate të përafërta.

3. Kuotat zgjedhore për gratë në kuadër të parimit të barazisë.

Përpjekjet që bëhen sot për të siguruar rritjen e pjesëmarrjes së grave në organet e larta të zgjedhura, si dhe për një rekrutim më të madh të tyre në pozicionet politike, përfaqësojnë padyshim çështjen më të rëndësishme për të arritur nivele të kënaqshme të barazisë gjinore në shoqëri. Qysh pas Luftës së II Botërore kur përfunduan me sukses aksionet e lëvizjeve feministe me vendosjen e votimit të përgjithshëm edhe për gratë, çështja gjinore është shndërruar në aksionin më të madh shoqëror për të finalizuar kërkesat për barazinë e përgjithshme në votim. Si pjesë thelbësore e parimit të barazisë, ajo është e lidhur pazgjidhshmërisht me sistemet zgjedhore në çfarëdolloj kuptimi që t'i analizojmë ato.

Aktualisht, në çdo sistem demokratik nuk ekzistojnë më barriera formalo-juridike për të ushtruar të drejtat zgjedhore. Barazia e kushteve për të zgjedhur e për t'u zgjedhur, është e qartë si për burrat edhe për gratë. Megjithatë, aktualisht gratë përfaqësojnë vetëm 15% të përbërjes së parlamenteve të të gjithë Botës. Pra, sistemet zgjedhore që praktikohen nuk janë në gjendje të na ofrojnë një ekuilibër gjinor të përfaqësuesve të zgjedhur. Duke parë hapat e ngadalta me të cilat po rritet numri i grave në institucionet politike, janë shtuar zërat që kërkojnë marrjen e masave më efikase për të arritur një balancë gjinore. Një nga mekanizmat që po përdoret gjithmonë e më tepër është vendosja e sistemit të kuotave për gratë në sistemin zgjedhor. Kjo, është bërë gjithashtu përmes një rezistence të madhe, për shkak të debateve të shumta që ka shkaktuar vendosja e tyre. Mjaft autorë mendojnë se dhënia e të drejtës së votës për gratë me vendosjen e votimit të përgjithshëm, është plotësisht e mjaftueshme për të siguruar barazinë në votim⁶. Çështja e zgjedhjes në organet për të cilat votohet, konsiderohet prej tyre si një çështje thjesht

1991-1992	Legjislatura e XII	250	10	4
1992-1996	Legjislatura XIII	140	8	5.7
1996-1997	Legjislatura XIV	140	21	15
1997-2001	Legjislatura XV	155	11	7
2001- 2005	Legjislatura XVI	140	9	6.4

* Të dhënat janë marrë nga libri "Gratë në Kuvend "

⁶ Shih: Drude Dahlerup, në www.quotaproject.org

individuale. Në fakt, ky mendim mbështetet mbi konceptin klasik liberal i cili e konsideron barazinë si "barazi e mundësive" ose "barazi konkurruese". Por, duke ndjekur lëvizjet e forta feministe të viteve të fundit, një koncept tjetër ka fituar terren dhe mbështetje më të madhe, koncepti i "barazisë së rezultateve". Sipas tij, nuk mjafton barazia formale dhe heqja e barrierave ligjore për të arritur një barazi të vërtetë reale. Për shkak të pengesave që ndodhen në realitetin shoqëror, veçanërisht për shkak të një konceptimi patriarkal të shoqërisë, nevojiten masa pozitive të afta për të çuar në barazinë e rezultateve. Këto e bëjnë të mundur shndërrimin e parimit të barazisë nga një opsion të sanksionuar formalisht në ligj, në një realitet të prekshëm. Në prespektivën e raportit të barazisë formale me atë thelbësore, ndërjegjësohemi se kuotat për gratë nuk përbëjnë një diskriminim kundrejt burrave, por një kompesim për pengesat strukturore me të cilat gratë ndeshen gjatë proceseve zgjedhore. Nga ana tjetër, kundërshtuesit e kuotave për gratë e lidhin këtë me faktin se ato mund të dëmtojnë cilësinë dhe ajo që duhet të na udhëheqë është cilësia⁷. Çështja e cilësisë është një çështje mjaft thelbësore, por natyrisht nuk janë kuotat për gratë ato që e dëmtojnë atë. Në të gjitha praktikat institucionale ku aplikohet konkurrimi (universitet, administratë publike etj.) vendet e fituara nga gratë janë të përafërta me ato të fituara nga burrat. Për këtë fasin të dhënat e pranimit në universitete, në të cilat përzgjedhja e studentëve bëhet me konkurs vetëm mbi kriteret aftësie⁸. Përbërja e studentëve në disa Fakultete të Universitetit të Tiranës, në vitin 2006, flet qartë për një epërsi të padiskutueshme numerike të vajzave që ndjekin këto fakultete. Kjo epërsi nuk ruhet në të njëjtat raporte në ciklet e kualifikimit pasuniversitar dhe në karrierën akademike, sikurse mund të gjykojmë nga të dhënat e stafit të këtyre fakulteteve⁹. Kjo, nuk është aspak pasojë e cilësisë, por e ndarjes së padrejtë të punës për

⁷ Po aty

⁸ **Fakulteti i Mjekësisë**, nga 2215 gjithsej /1491 femra

Fakulteti i Histori-Filologjisë, nga 1797 gjithsej /1344 femra

Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, nga 2403 gjithsej 1631 femra

Fakulteti i Ekonomisë, nga 16771 student gjithsej / 11651 femra

Fakulteti i Shkencave Sociale, nga 1722 gjithsej / 1348 femra

Fakulteti i Drejtësisë, nga 1149 gjithsej / 632 femra

Fakulteti i Shkencave të Natyrës, nga 2256 gjithsej / 1639 femra

Fakulteti i Infermierisë, nga 1353 gjithsej/ 1013 femra

⁹ Në **Fakultetin e Mjekësisë**, nga 142 punonjës gjithsej me titullin Prof / 23 femra; nga 117 gjithsej me titullin As.prof / 52 femra ; nga 119 pedagogë me gradë /49 femra; nga 71 ped pa grade/ 46 femra ; nga 256 gjithsej as.ped / 182 femra.

Në **Fakultetin e Histori-Filologjisë**, nga 20 gjithsej Prof / 3 femra; nga 10 gjithsej As.prof/ 1 femër; nga 8 gjithsej pedagogë me gradë /3 femra; nga 7 gjithsej ped. pa gradë/ 4 femra; nga 19 gjithsej as.ped/ 11 femra.

Në **Fakultetin e Gjuhëve të Huaja**, nga 6 gjithsej Prof / 1 femër; nga 16 gjithsej as.prof/ 9 femra; nga 9 gjithsej ped. me gradë / 7 femra; nga 14 gjithsej ped. pa gradë/ 9 femra; nga 66 as.ped/ 47 femra

Në **Fakultetin e Ekonomisë**, nga 22 gjithsej Prof / 5 femra; nga 20 gjithsej As.prof/ 13 femra; nga 9 gjithsej ped me gradë /7 femra; nga 2 ped. pagradë/ 1 femër; nga 48 gjithsej as.ped/ 38 femra

Në **Fakultetin e Shkencave Sociale**, nga 3 gjithsej Prof/ 1 femër; nga 7 gjithsej As.prof/ 2 femër; nga 6 ped. me gradë/ 4 femër; nga 1 ped. pa gradë/ 1 femër; nga 21 as.ped./ 19 femra

Në **Fakultetin e Drejtësisë**, nga 3 gjithsej Prof/ 1 femër; nga 2 gjithsej As.prof/1 femër; nga 12 ped. pa gradë / 7 femra; nga 15 as.ped./ 12 femra.

Në **Fakultetin e Shkencave të Natyrës**, nga 43 gjithsej Prof / 6 femra; nga 16 gjithsej As.prof/ 10 femra; nga 18 gjithsej ped. me gradë/ 8 femra nga 4 gjithsej ped. pa gradë/ 0 femra; nga 31 gjithsej as.ped./ 22 femra

gratë, të cilat pasi përfundojnë studimet e larta, krijojnë familjet, kujdesen për to dhe fëmijët dhe kanë pak mundësi e kohë fizike për të ndjekur studimet, veçanërisht në ciklin e tretë të tyre (studimet për marrjen e gradës “doktor”).

Në lidhje me përfaqësimin politik, mosmiratimi i kuotave për gratë, për shkak të cillësisë, na duket argumenti më i pagjetur. Për më tepër, elementët e cilësisë janë lënë pas dore, duke kërkuar që vullneti i popullit të përkthehet vetëm në numra, në emër të barazisë në votim e përfaqësim. *“Vëmendja jonë është drejtuar përherë e më shumë mbi çështjen e përfaqësisë së saktë, në sa më mirë o sa më keq, votat kthehen në vende. Ernes Bakëri ishte pak a shumë, autori i fundit madhor që thekson në 1942 se “nuk mund të heqim dorë nga ideja e vlerës, nuk mund të fronësojmë shumicën vetëm pse është shumicë dhe më e madhe në numër. Duhet të gjejmë një mënyrë për të lidhur bashkë vlerën dhe numrin si gjëra të lidhura në mënyrë të pandashme””* (Giovani Sartori, *“Edhe njëherë për teorinë e demokracisë”*).

Të gjitha shoqëritë shtetërore janë ndeshur me problemin e pjesëmarrjes së grave në qeverisje dhe kanë marrë disa masa. Më të rëndësishme kanë qenë sistemet e kuotave të inkuadruara në sistemet zgjedhore.

4. Kuotat dhe sistemet e tyre. Sistemet e kuotave zgjedhore janë të ndryshme. Ato mund të zbatohen me qëllim që të rezervojnë një numër të caktuar vendesh për gratë në organet e zgjedhura, duke iu ofruar atyre mbështetje për të dalë nga izolimi politik. Ideja e vërtetë e sistemit të kuotave qëndron në rekrutimin e grave në pozicionet politike. Por sistemet e kuotave mund të aplikohen edhe mbi baza të tjera sociale, p.sh., për të garantuar përfaqësimin e minoriteteve, ose mbi baza gjeografike, me qëllim që të sigurojnë në çdo rast një përfaqësim minimum të zonave të populluara. Sistemet e kuotave *gender* synojnë që të sigurojnë së paku një minoritet kritik për gratë, prej 20, 30, ose 40 %, e deri në garantimin e një balance të vërtetë gjinore, prej 50 % burra-50 % gra. Ato përbëjnë padyshim një aspekt mjaft të rëndësishëm të sistemeve të kuotimit, për faktin se pothuajse në të gjitha shtetet, gratë përbëjnë rreth 50% të popullsisë, ndërkohë që përfaqësimi i tyre mbetet në nivele mjaft të ulta.

A. Llojet e kuotave sipas korrektimit në sistemet zgjedhore. Sido që të paraqiten, kuotat përfaqësojnë një korrektim të sistemeve zgjedhore. Nisur nga ky fakt kuotat gjinore paraqiten të ndryshme. Një korrektim me kuotë gjinore mund të kërkojë që së paku 40% të kandidatave në listën elektorale të jenë gra. Kjo mund të shoqërohet edhe me një maksimum të kërkuar për gjininë mashkullore.

Disa sisteme kuotash paraqiten *si sisteme gjinore neutrale*. Në këtë rast, korrektimi i sistemit zgjedhor kryhet në mënyrë të tillë që asnjëri prej të dyja gjinive të mos kapërcejë një maksimum të vendosur. P.sh., asnjëra prej gjinive të mos zerë më tepër se 60% të vendeve, ose më pak se 40% të vendeve në parlament. Në rastin kur kuota kërkon një

korrektim prej 50-50%, atëhere kemi të bëjmë me një kuotë neutrale natyrore, e cila vendos një maksimum për përfaqësimin e grave.

Është praktikuar gjithashtu edhe koncepti i “*double quota*”, i kuotës së dyfishtë, që konsiston në korrektimin e sistemit zgjedhor jo vetëm përmes një përqindjeje të caktuar për gratë në listën elektorale, por gjithashtu parashikon që gratë kandidate të vendosen në krye të listave me shanse të vogla për t’u zgjedhur. (Belgjika, Argjentina).

Sistemet e kuotave zgjedhore për gratë mund të jenë të përkohshme ose jo. Në rastin e parë parashikohet një kohë e kufizuar në të cilën duhet të vendosen e të zbatohen këto kuota, duke u konsideruar si masa të përkohshme derisa të shmangen barrierat për gratë, brenda politikave të ndjekura. Edhe pse mjaft shtete që kanë parashikuar kuota, nuk kanë vendosur limite kohore për përdorimin e tyre, duket se tendenca e fundit është për të mbështetur më tepër sistemet e kuotave të përkohshme. Kjo, me qëllim që të tregohet përkohshmëria e aksioneve politike të shtetit, deri në zhdukjen e të gjitha barrierave që ekzistojnë në realitetin patriarkal të politikave zgjedhore. Një gjë e tillë duket qartë edhe në rekomandimet që Komiteti i Kombeve të Bashkuara për Eliminimin e Diskriminimit kundër Grave, i ka bërë shtetit shqiptar¹⁰. Ndërsa mirëpriti përdorimin e kuotave minimale të kandidateve femra nga disa parti politike shqiptare në zgjedhjet lokale, Komiteti shprehu shqetësimin për përfaqësimin e ulët të grave në nivelet e larta të zgjedhura dhe të emëruara dhe, i bëri thirrje palës qeveritare shqiptare të marrë masa që përfshijnë përmirësime në ligjin elektorale, rritjen e përfaqësimin e grave në organet e zgjedhura apo të emëruara nëpërmjet zbatimit të masave të përkohshme specifike, me qëllim që të realizojë të drejtat e grave për t’u përfshirë në të gjitha fushat e jetës publike, veçanërisht në nivelet e larta të vendimmarrjes.

B. Sistemet e kuotave. Nisur nga juridiksioni në të cilat shtrihet fuqia e sistemeve të kuotave, i ndajmë ato në dy tipe kryesore:

I. Sistemet e kuotave të parashikuara për Parlamentet në nivel kombëtar.

II. Sistemet e kuotave të parashikuara për organet e qeverisjes lokale (jo-kombëtare)

I. Forma juridike me të cilën janë sanksionuar sistemet e kuotave i bën ato të larmishme nga njëri vend në tjetrin. Megjithatë, mund të klasifikohen si më poshtë:

1. Sistemi i kuotave kushtetuese. Janë kuota të parashikuara nga dispozitat e Kushtetutës së një vendi. Kryesisht, ato vendosen për Parlamentin, (Franca etj.).
2. Sistemi i kuotave legislative ose rregullatore. Në këtë rast kuotat vendosen nga ligje të brendshme të vendit, ose nga akte të tjera me fuqi nënligjore. Aplikimi i këtij sistemi është karakteristikë për vendet e Amerikës Latine, por është përdorur edhe në Evropë (Belgjikë, Serbi, Maqedoni, Bosnje&Hercegovinë etj.).

¹⁰Rekomandime të Komitetit pas raportit të parë të shtetit shqiptar për zbatimin e Konventës „Për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit për gratë“ (CEDAW) Sesioni 28, 13-31 Janar 2003

3. Sistemi i kuotave të vendosura nga Partitë politike për kandidaturat në zgjedhje. Ky është edhe sistemi më i përhapur në Evropë (Gjermani, Itali, Norvegji, Suedi, Angli etj.). Ai konsiston në rregulla të vendosura nga partitë politike për të përfshirë një përqindje të detyrueshme të grave si kandidatë në zgjedhje. Në këtë rast, është vetë vullneti i partive politike që ka rëndësi për vendosjen e kuotave. Nuk ka detyrime ligjore për to. Madje, mund të ndodhë që në disa vende, të gjitha partitë politike të kenë parashikuar kuota, ndërkohë që në disa vende të tjera vetëm një ose disa prej tyre mund të vendosin kuota. Një pjesë e madhe e partive politike në të gjithë Botën nuk aplikojnë ndonjë kuotë. Sidoqoftë, nëse shumica e partive politike të një vendi i përdor këto kuota, ky sistem ka rezultuar mjaft frytdhënës dhe i ka rritur standartet e përfaqësimit të grave.

II. Sistemet e kuotave të parashikuara për organet e zgjedhura jo në nivel kombëtar janë gjithashtu të larmishme dhe perifrashohen sikurse kuotat kombëtare. Në këto raste përmes kuotave kushtetuese ose legjislativive për organet e qeverisjes vendore, kërkohet një set i përcaktuar i vendeve për gratë, me qëllim që ato të përbëjnë një përqindje të arsyeshme të kandidatëve në nivelin e qeverisjes jo kombëtare (në rastin e vendit tonë të qeverisjes vendore). Shembuj të tillë janë të shumtë: Greqi, Maqedoni etj.).

5. Çështje të zbatimit të kuotave. Niveli më i lartë i sanksionimit të kuotave nuk ka rezultuar gjithmonë më i suksesshmi. Për fat të keq, as kuota kushtetuese dhe as ajo legjislativive nuk na tregojnë ndonjë epërsi mbi rastet kur është vendosur kuota e partive politike. Ndërkohë, është vërtetuar plotësisht se, kyçi i suksesit në arritjen e standarteve më të mira në përfaqësimin gjinor, mbetet puna në partitë politike. Nuk është e rastësishme që pikat më të larta të përfaqësimit të grave në parlamentet e sotme në Europë, janë arritur nga vende që përdorin sistemin e kuotave nga partitë politike: Suedia: 45, 3% Austria: 40% Danimarka etj., 36%. Ndërkohë, Franca, një nga vendet me traditat më të vjetra demokratike, edhe pse e ka përforcuar sistemin e kuotës duke e garantuar me kuota kushtetuese e ligjore të shoqëruar me sanksione për moszbatimin e tyre, ka një përfaqësim të ulët të grave në parlament prej 12.1%. Aktualisht, Shqipëria shënon standartin më të ulët të përfaqësimit të grave në Evropë dhe paraqitet me 7.1% gra në Kuvend.

Në Kodin e sjelljes që u nënshkrua nga të gjitha partitë politike në kuadër të zgjedhjeve parlamentare të vitit 2005 theksohej shprehimisht: “*Ne do të nxisim dhe mbështesim konkretisht pjesëmarrjen e plotë të grave, qoftë si kandidatë edhe si anëtarë të komisioneve në procesin zgjedhor*”. Partitë më të mëdha politike parashikuan edhe një kuotë për kandidaturat e grave në këto zgjedhje. Megjithatë, rezultatet ishin krejt të pakënaqshme¹¹, duke shkuar vazhdimisht në rënie. Kjo rënie mund të spjegohet sidomos

-
- ¹¹ Kryetarë të KZZ-ve të propozuar nga Partitë politike: 100 gjithsej/4 gra
 - Kryetarë të KQV-ve: gra 16%
 - Politikanëve meshkuj iu dha 95% e minutazhit politik në media.
 - Në zonat njëemërore:

me ashpërsinë politike të viteve të tranzicionit, pasi Shqipëria ka trashëguar potenciale të përshtatshme për përzgjedhje nga radhët e grave, si dhe ka patur përfshirje të konsiderueshme të grave në Parlament, pavarësisht nga fakti se kjo diktohej nga sistemi komunist. Edhe kuotat, fillimisht vendosin njëfarë imponimi demokratik.

Të bën përshtypje fakti se kuotat veprojnë në mënyra të ndryshme në sisteme të ndryshme elektorale. Është e qartë se në një sistem proporcional, vendosja e tyre paraqitet më e lehtë. Megjithatë në mjaft vende ajo është përdorur me sukses edhe në sistemet mazhoritare. Madje, ka ndodhur që edhe në sistemin proporcional kuotat të kenë qenë të vështira dhe jo fort rezultative, për shkak të dobësisë së partive politike në përzgjedhjen e kandidatëve.

Në këtë kuadër, çështja arritjes së niveleve bashkëkohore në Shqipëri, shtrun detyra të rëndësishme në kuadrin e politikave zgjedhore. Ndërtimi i një platforme për të harmonizuar legjislacionin shqiptar në lidhje me barazinë gjinore (Kodi zgjedhor dhe Ligji “Për një shoqëri gjinore të barabartë”), do të sillte nevojën e parashikimit nga këto akte të masave të veçanta dhe të përkohshme për të arritur balancën gjinore. Ligji “Për një shoqëri gjinore të barabartë”, mund të përmbajë përkufizime që japin koncepte të qarta mbi këto lloje masash si dhe mbi kuptimin e përfaqësimit të barabartë. Kurse, Kodi zgjedhor mund të përcaktojë një sistem kuotash, ose lejimin e një sistemi kuotash së bashku me sanksionet për moszbatimin e tyre.

- Në vijim të rekomandimeve të dhëna për Shqipërinë nga Komiteti i Kombeve të Bashkuara për Eliminimin e Diskriminimit kundër Grave, do të ishte bindës parashikimi i kuotave legjislative neutrale dhe të përkohshme, me një afat të kufizuar. Kjo mund të realizohet në disa mënyra:
 1. Të mëshohet puna në partitë politike me qëllim që të aplikohet kuota e partive politike për kandidatët për organet qendrore realisht deri në masën 30% të kandidaturave për të dyja sistemet, ose 50% për proporcionalin.
 2. Për organet vendore të parashikohet një kuotë legjislative e përkohshme nga Kodi zgjedhor. Kjo do të ishte më rezultative, pasi organet kolegjiale vendore zgjidhen mbi bazën e sistemit proporcional, që sikurse theksuam, i përgjigjet më me lehtësi sistemit të kuotave. Kuota legjislative është e rekomandueshme për Shqipërinë sepse, ajo ka potencialin e nevojshëm intelektual për përzgjedhje nga radhët e grave, si dhe duke patur parasysh se gjatë të gjitha viteve të demokracisë emergjente, numri i grave që marrin pjesë në organet e zgjedhura ka rënë ndieshëm.

-
- PS kandidoi me 8 gra/4 prej tyre fituan
 - PD kandidoi me 3 gra/3 prej tyre fituan
 - Në grupin parlamentar të PSD: në 7 deputetë/2 janë gra
 - Shtatë parti parlamentare nuk kanë asnjë deputete grua në radhët e tyre.

3. Parashikimi i kuotave tranzitore legislative për organet përfaqësuese qendrore, mund të vendoset me këndvështrim të posaçëm në proporcional, në të cilin mund të aplikohet edhe kuota e dyfishtë.
4. Ligji mund të parashikojë sanksione të ndryshme për partitë politike që nuk përmbushin kuotat e vendosura (sanksione që përmbushen nga KQZ, si mospranimi i listave, sanksione financiare ndaj partive që nuk realizojnë kuotat e parashikuara për kandidatët, bllokimi i regjistrimit të subjektit dhe kandidatëve deri në balancimin e kuotave në zbatim të kodit, ose të normave statutores të parashikuara nga vetë subjekti, etj.)
5. Kodi zgjedhor mund të parashikojë detyrimin e partive politike për t'u përfaqësuar në njësitë e administrimit të votës mbi baza neutrale gjinore.

Sidoqoftë, në përfundim, ia vlen të përsëritim faktin se, roli i partive politike në rritjen e pjesëmarrjes së grave në jetën politike të vendit mbetet vendimtar.

LITERATURA:

1. Ney Bensadon, "*Les droits de la Femme*", Presses Universitaire de France, Paris, 1994
2. Drude Dahlerup, në www.quotaproject.org
3. Kristo Floqi, *E drejta Themelore*, Shkodër 1920
4. Aurela Anastasi, Institucionet politike dhe e drejta Kushtetuese në Shqipëri (1912-1939), Shtëpia Botuese "Luarasi", Tiranë, 1998, fq. 261
5. "Zgjedhjet për Kuvendin", Raporti i Misionit të Vëzhgimit të Zgjedhjeve i OSBE/ODIHR-it, 3 korrik 2005